

Proletar HASANI & Marenglen KASMI

Ndihmesa e Ushtrisë shqiptare në organizimin dhe përgatitjen e forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Para pak ditësh Kosova përkujtoi me madhështi Dhjetëvjetorin e Pavarësisë dhe me të drejtë, Pavarësia e saj ishte e merituar. Ajo ishte realizim i ëndrrës qindvjeçare të popullit të Kosovës për çlirim dhe një shtet të pavarur e sovran. Por, sigurisht dhe padyshim që në themel të Pavarësisë qëndron lufta dhe gjaku i luftëtarëve dhe i dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me mbështetjen e fuqishme, efektive dhe të pandërprerë të forcave të NATO-s, që u dha me bekimin e SHBA-së dhe të Evropës.

Ndonëse që nga fitorja e luftës së UÇK-së me mbështetjen e NATO-s, kanë kaluar më pak se njëzet vjet, tashmë UÇK dhe lufta e saj për çlirimin e Kosovës janë bërë pjesë e historisë më të lavdishme të popullit të saj, që çoi në çlirimin e vendit dhe shpalljen e Pavarësisë. Por, edhe UÇK-ja ka historinë e saj, fillimet e së cilës, organizimi dhe armatosja, stërvitja dhe përgatitja, njohja artin e luftës, të zhvillimit e drejtimit të saj drejt fitores së luftës ashtu si dhe liderët e organizatorët e saj të shquar, gjenden përpara në kohë. Në këtë histori, një pjesë jo pak tërëndësishme zënë padyshim edhe ata njerëz e vende, që e mbështetën organizimin, furnizimin, disiplinimin dhe stërvitjen e përgatitjen luftarake të kësaj ushtrie të re.

Kjo është një temë, trajtimi i së cilës deri tani ka qenë tabu. Por, tashmë, kur edhe cikli historik, pas 20 vjetësh është përmbushur, është detyra e historiografisë që të zbardhë e shkruajë me mjete dhe teknika

shkencore këtë pjesë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Siç e theksuam, trajtimi i kësaj teme është shumë delikat dhe vështirësohet ende nga mungesa e burimeve arkivore, qoftë vendase apo të huaja. Nëse për vitet 1980-1990 dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit mundësojnë një skicim të mirë të problematikës së Kosovës në këto vite dhe përpjekjeve të saj për t'u çliruar, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për vitet 1990-1999, sepse arkivat janë ende të kyçura për këtë periudhë.

Në një vlerësim të përgjithshëm që kemi kryer nga fondet arkivore të Sigurimit të Shtetit, mund të themi se Tirana komuniste e ndiqte me shumë kujdes situatën në Kosovë. Raportet e hartuara nga Sigurimi i Shtetit e vërtetojnë këtë gjë. Sigurisht që ky dokumentacion mbart një sërë problematike me vete, duke pasur parasysh që përmenden emra, jepen opinione etj., dhe jo rrallë hasen edhe lista bashkëpunëtorësh të UDB-së apo të Sigurimit të Shtetit, e sidomos nga radhët e intelektualëve. Për periudhën 1990-1999, përveç faktit se arkivat janë ende të mbyllura, duhet theksuar edhe fakti se, ndoshta jo gjithçka është bërë me shkrim dhe ka lënë gjurmë në arkivat e institucioneve shqiptare. Pavarësisht këtyre vështirësive, studimi i autorëve të huaj, si: Jens Reuter, Peter Schubert, Agilof Keßelring, Fred Abrahams, por edhe i atyre shqiptarë, mundësojnë trajtimin e kësaj teme. Po ashtu, një dimension të rëndësishëm studimor, përbëjnë edhe dëshmitë e oficerëve shqiptarë, të cilët u përfshinë drejt për së drejti në stërvitjen e luftëtarëve kosovarë, si në vitet 1991-1993, ashtu edhe masivisht më pas, gjatë luftës së Kosovës.

Viti 1991 shënoi rënien e regjimit komunist në Shqipëri. Shumë shqiptarë ishin të mendimit se, si regjimi i Enver Hoxhës, ashtu edhe qeveria e pasardhësit të tij, Alia, nuk kishin bërë asgjë për bashkimin e gjithë shqiptarëve.¹ Tradicionalisht, vizioni i një bashkimi kombëtar shqiptar, kishte qenë ajo çka elita shpirtërore dhe intelektuale shqiptare kishin artikulluar në vazhdimësi. Ishte pikërisht kjo elitë, e cila shpresonte që tashmë, me rënien e regjimit komunist, qeveria e parë demokratike shqiptare do të angazhohej fuqishëm në zgjidhjen e çështjes kombëtare. Sigurisht që edhe zhvillimet në Evropën Lindore dhe bashkimi i Gjermanisë, zgjonte te kjo elitë shpresën se, zgjidhja e çështjes kombëtare ishte një hap më pranë realizimit. Fillimi i luftës për shthurjen e Jugosllavisë në verën e vitit 1991, shkaktoi jo pak shqetësime në Tiranë. Nga njëra anë, Tirana trembej në zgjerimin e një konflikti edhe në Kosovë, e rrjedhimisht edhe në Shqipëri dhe, nga ana tjetër shpresonte se humbja e Serbisë në këtë konflikt, do të ishte në favor të zgjidhjes së çështjes kombëtare. Ndonëse në fillim vitet '80 ishte hartuar një plan me karakter difensiv përgjatë kufirit me ish-Jugosllavinë, ai kishte në të edhe elementë planëzues ofensivë, për territorin e Kosovës.² Për Tiranën e vitit 1991 ishte e qartë se një konflikt i armatosur me Jugosllavinë në këtë kohë ishte diçka shumë e rrezikshme.

¹ Shiko Jens Reuter: Optionen der internationalen Gemeinschaft zur Lösung der albanischen Frage. (Erstmalig erschienen in: Zur Problematik der Stabilisierung des Westbalkans. Hg. von der Landesverteidigungsakademie Wien und vom Militärwissenschaftlichen Büro. Wien 2000 (=Studien und Berichte zur Sicherheitspolitik 5/2000), S 55-75).

² Për më shumë informacion shih: Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Prishtinë: "Instituti i Historisë", 2012, f. 250-251.

Gjithsesi, ka burime të cilat tregojnë se, në vitin 1991, Ramiz Alia pranoi që ushtria shqiptare të fillojë stërvitjen e disa luftëtarëve kosovarë. Historiani gjerman, Agilof Keßelring, shkruan se “*Si klani i Jasharajve, ashtu edhe FARK-u dhe UÇK-ja u stërvitën pjesërisht në të njëjtën qendra stërvitore në anën shqiptare të kufirit, pra në Shqipëri. Këto fraksione të ndryshme kishin synime të njëjta madhore shqiptare. Megjithatë në fillimvitete ‘90 ekzistonte një konkurrencë ndërmjet tyre. Po ashtu, këto fraksione ndryshonin shumë edhe në pikëpamje të strategjive për realizimin e qëllimeve politike*”.³

Ndër të parët që do të stërvitej në kampet ushtarake të ushtrisë shqiptare të ngritura me urdhrin e Alisë ishte edhe Adem Jashari. Lidhur me këtë fakt, Fred Abrahams në librin e tij “Shqipëria e re”, ka shkruar për një bisedë që ka zhvilluar në vitin 1991 ish- presidenti i Shqipërisë i asaj kohe, në një takim me Xhavit Halitin. Abrahams shkruan: “*Alia mundësoi njëfarë stërvitjeje, më treguan se Haliti, ashtu edhe ministri i Mbrojtjes, Teta, LPRK-ja dërgoi në Shqipëri njerëz, duke përfshirë një luftëtar trupmadh që e quanin Adem Jashari...*”⁴.

Ky autor shkruan se personi i parë që erdhi në Shqipëri ishte Xhavit Haliti, përfaqësues i Lëvizjes për Republikën e Kosovës (LPRK) dhe në korrikun e vitit 1991 u takua me presidentin e asaj kohe, Ramiz Alinë. Ai e takoi presidentin me qëllimin dhe mendimin rreth fillimit “*të një lëvizje ushtarake për çështjen e Kosovës*”.⁵ Presidenti shqiptar që i njëjti mirë grupet e ndryshme kosovare, besonte se Kosova mund të çlirohej vetëm me anë të forcës.⁶ Për të mbajtur lidhjet,

³ Keßelring, f. 312.

⁴ Shih dhe Fred C. Abrahams, *Shqipëria e Re*, Tiranë; Dudaj, 2015, f.313.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Po aty*.

ai caktoi këshilltarin e tij ushtarak, gjeneralmajorin Adem Çopanin, i cili ishte një ushtarak i lartë i karrierës me përvojë.

Por, në fillimet, siç është shprehur edhe ish-Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, aso kohe pati vështirësi, sepse, atëherë erdhën shumë grupe që kërkonin ndihmë. Ministria e Mbrojtjes urdhëroi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve që me katedrat e saj të taktikës, zjarrit, zbulimit, xhenios etj., të hartonte dhe zhvillonte një plan stërvitor për grupe stërvitore me shqiptarë të Kosovës. Lidhur me stërvitjen ushtarake të luftëtarëve kosovarë, një autor dhe dëshmitar i kësaj lufte, ka shkruar se përgatitjen ushtarake Adem Jashari e ka marrë në Shqipëri, nga oficerë të njohur të Ushtrisë Shqiptare⁷. Siç e theksuam, stërvitja e tyre u zhvillua nga pedagogët më të mirë të Shkollës së Bashkuar, kështu që ky është një vlerësim mëse i drejtë. Për fat të keq, ende nuk kemi gjetur burime arkivore të plota, për të arritur në të dhëna më të plota për emrat, sasinë e grupeve dhe atë çka këto grupe përfaqësonin.

Sipas dëshmimeve të disa oficerëve të Shkollës së Bashkuar që trajnonin luftëtarët kosovarë, në vitin 1992, me largimin e Alisë dhe ardhjen e Presidentit Berisha, stërvitja e luftëtarëve kosovarë u ndërpre. Vlerësuar sot në retrospektivë, ky veprim nuk përbën ndonjë çudi. Para se Berisha të zgjidhej president, deklaratat e tij në lidhje me Kosovën shkonin në drejtim të irredentizmit.

Ndryshe si kryetar shteti: *“Tirana e vlerësonte ndjekjen e një politike irredentiste në Kosovë, që mund të përfundonte në një luftë, si një rrezik jetik. Në këtë kohë të gjithë donin të shmangnin me çdo kusht një konflikt në Kosovë. Me politikën e tij paqësore, Ibrahim Rugova ishte një aleat natyral i Tiranës. Duket sikur ai ofron garancitë që kosovarët nuk do të kalojnë në një kryengritje të dhunshme, çka mund*

⁷ Halil Katana, Kadusi Lama - gjenerali i luftës, Tiranë: MOKRA, 2002.

të dëmtojë edhe Shqipërinë”,⁸ shkruan historiani gjerman, Jens Reuter. Në këto vite bie në sy që Qeveria shqiptare kërkonte me çdo kusht të shmangte konfliktet në Kosovë.

Mbyllja e kampeve stërvitore ishte një rrjedhim i politikës së ndjekur nga qeveria e asaj kohe duhet vlerësuar në dy plane, si në atë të vizionit politik për çështjen e Kosovës, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në planin e brendshëm ndërprerja e mbështetjes për UÇK-në erdhi si pasojë edhe e frikës dhe dyshimeve kundër grupeve “majtiste”, ndërsa në planin ndërkombëtar, si pasojë e presionit të tyre. Qeveria e Tiranës nuk mund të dilte kundër politikës së ndjekur nga Brukseli dhe Uashingtoni. Pa ndihmën financiare të Perëndimit, ajo nuk do të mbijetonte.

Në një situatë dhe kontekst krejt të ndryshëm ishte ndihma që UÇK-ja do të merrte në vitet 1997-1999. Në vitet 1997-1998, ndonëse qeveria shqiptare e kohës i ruhej një reagimi të komunitetit ndërkombëtar, përfaqësuesit e UÇK-së u lidhën dhe u ndihmuan nga institucionet e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Informimit Shqiptar. Nëpërmjet kësaj marrëdhënie, që doli se ishte e duhura dhe vendimtare, teksa konflikti po përhapej, UÇK-ja mori ndihmën më të mundshme.⁹

Nëse i referohemi historisë së krijimit të UÇK-së, sipas disa studiuesve të saj, fillimet e saj janë të kahershme. Fillesat apo zanafilla e saj duhen kërkuar që në kohën e Lëvizjes Politike, ilegale të pas Luftës së Dytë Botërore, e cila kulmoi me demonstratat e vitit 1981, në Kosovë.

Atë kohë kërkesa themelore e demonstratave ishte “Kosova Republikë”! Sipas të dhënave të njohura të kohës, këta demonstrues,

⁸ Reuter, f. 57.

⁹ Fred C . Abrahams, f. 312.

kudo që ndodheshin, në harkun kohor 1981-1990, nuk reshtën së kërkuari përmbushjen e çështjes së tyre, në rrjedhën e të cilave u krijuan organizatat e ndryshme politike¹⁰. E përbashkëta e këtyre organizatave, në programet e tyre, qëndronte kërkesa për luftën e armatosur çlirimtare. Ndërkohë, veprimtarët e këtyre organizatave, do të ishin ata që do të përbënin bërthamën e saj, që do të lindte së shpejti për konkretizimin dhe realizimin e luftës së armatosur çlirimtare.

E parë në pikëpamje historike, krijimi dhe organizimi i UÇK-së kaloi përmes disa fazave kryesore, secila prej të cilave pati veçoritë e veta. Kësisoj, pas fazës së parë, që përfshinë vitet 1981-1990, kështu që bënte më tepër se kristalizimin e idesë për luftën e armatosur, organizimi konkretizohet në fazën paraardhëse. Në fazën e dytë, që do të niste në pranverën e vitit 1991 dhe do të shtrihej deri në shkurtin e vitit 1998, pasoi organizimi i njësiteve të vogla dhe njëherësh, ato ndërmorën edhe aksione të armatosura kundër politikës serbe në territorin e Kosovës. Në vitin 1991 ndodh një ngjarje, ku bën pjesë një ndër personalitetet e luftës dhe ndër nismëtarët e krijimit të UÇK-së, atdhetari dhe ai që më pas do të shndërrohej në heroin e luftës së Kosovës, Adem Jashari. Ai, së bashku me një grup atdhetarësh nga Kosova, Zvicra etj., u stërvitën ushtarakisht jashtë Kosovës dhe u rikthyen të armatosur në të. Pas kësaj, ky grup u bë nismëtar dhe organizator për krijimin e njësiteve të para të vogla, të armatosura pothuajse në çdo anë të Kosovës. Lidhur me stërvitjen ushtarake të këtij luftëtari dhe komandanti të madh të luftës së Kosovës, një autor dhe dëshmitar i kësaj lufte, ka shkruar se përgatitjen ushtarake Adem

¹⁰ FESH, Vëll. 3, Tiranë: Botimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, 2009, f. 2827-2830.

Jashari e ka marrë në Shqipëri, nga oficerë të njohur të Ushtrisë shqiptare.¹¹

Krijimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në nëntor 1994, çoi në bashkërendimin e veprimeve me zonat e tjera të Kosovës, me grupet luftarake të ngritura deri atëherë në to. Por, UÇK-ja u shfaq hapur në publik pikërisht më datën 28 nëntor të vitit 1997, me uniformat dhe simbolet e kësaj ushtrie.

Faza e tretë, që u shtri në muajt mars-shtator 1998, nisi fill pas rënies heroike të Adem Jasharit dhe familjes së tij. Në këtë fazë, UÇK-ja u rrit me shpejtësi duke u përhapur dhe shtrirë pothuajse në krejt hapësirën e Kosovës. Ndërkohë, zgjerim pati edhe veprimtaria luftarake e saj, duke çliruar disa zona të Kosovës. Kësisoj ajo krijoi disa baza strategjike, u armatos dhe nisi të krijonte reparte të rregullta që u përgatitën nëqendrat e stërvitjes së saj, sipas kërkesave dhe kushteve të ushtrive të kohës.

Si rrjedhojë e këtyre treguesve, në pranverë dhe verë të vitit 1998, UÇK ia doli të vinte nën kontroll të degëzimeve të rrugëve që kalonin pothuajse në tërë zonat. Për pasojë forcat policore serbe u detyruan të tkurrëshin dhe përqendroheshin në qytetet e mëdha të Kosovës.

Ajo që shënoi njohjen e parë nga SHBA dhe, më tej, nga Evropa të UÇK-së dhe luftës së saj, ishte takimi i diplomatit të shquar amerikan, Riçard Hollbruk (Richard Hoolbruck), me përfaqësues të UÇK-së, në Junik të Kosovës, takim ky që u ligjërua në Konferencën e Rambujesë, në Francë, ku UÇK-ja u njoh ndërkombëtarësh.

Historikisht, faza e katërt, që rrok segmentin kohor shtator-tetor 1998deri në qershor të vitit 1999, filloi pas mësymjes së forcave policore-ushtarake serbe. Në këtë fazë, UÇK, megjithëse mori goditje

¹¹ Halil Katana, Kadusi Lama - gjenerali i luftës, Tiranë: MOKRA, 2002.

të rëndë, nuk u asgjësua siç qe synimi siç deklaronte Serbia, por ajo ia doli të mbijetonte, madje u riorganizua shpejt në formacione më të mëdha, në brigada!

Në një tjetër këndvështrim, strategjia ushtarake e UÇK-së, bazohej në konceptin e vazhdimësisë në rritje të luftës së armatosur, duke ardhur gradualisht nga njësitet e vogla në njësi të mëdha. Ky koncept, në thelb kishte për qëllim mobilizimin dhe afrimin e sa më shumë luftëtarëve kosovarë për t'i detyruar tek e fundit, forcat ushtarake pushtuese serbe të largoheshin nga Kosova. Strategjia ushtarake kishte përcaktuar edhe taktikën që formacionet e UÇK-së, në ecurinë e organizmit ushtarak të tyre dhe të fazave të zhvillimit të luftës, do të përdornin kundër forcave pushtuese ushtarake-policore serbe në Kosovë. Por, kjo taktikë vinte në qasje dhe përputhje me fazat e organizimit ushtarak të forcave të UÇK-së. Për rrjedhojë, në fazën e dytë, lufta e UÇK-sëe kondicionuar nga numri i forcave dhe përmasave të vogla tëformacioneve të UÇK-së, u zhvillua sipas taktikës së luftës guerile, me aksione të vogla, me goditje të kryera brenda një kohe të kufizuar, që pasoheshin me tërheqje në zonat e tyre të sigurta.

Kurse në fazën tretë, që u karakterizua nga krijimi i zonave të lira, veprimet luftarake të UÇK-së u përqendruan kryesisht në bllokimin e rrugëve të komunikacionit dhe mbrojtjes së zonave të lira nëpërmjet taktikës së luftës ballore (frontale), nga pozicione të përgatitura, madje edhe me punime xheniere.

Kalimi në taktikën e luftës pozicionale, u krye nga forcat e UÇK-së në kushtet e detyrimit nga domosdoshmëria për të mbrojtur popullin e zonës përkatëse nga boshatisjet dhe masakrat e forcave serbe. Një gjë e tillë solli për rrjedhojë rritjen e autoritetit të UÇK-sëbrenda në

Kosovë edhe në Evropë dhe mbarë botën, por edhe shtimin e zonave të lira kosovare.

Por, në fazën e katërt, gjatë fushatës serbe për spastrimin rrënjësor të Kosovës, që e pamundur që të zbatohej kudo luftë ballore (frontale), gjë që shtyu UÇK-në të hiqte dorë nga mbrojtja me çdo kusht (deri në fund) të zonave të lira. Por, në këtë fazë, u mbrojtën bazat strategjike dhe korridorët e furnizimit, që ishin të domosdoshme për vijimin e furnizimeve dhe të luftës së UÇK-së. Për këtë arsye, në këtë fazë u kalua në veprimet luftarake jo me front të rregullt. Tashmë UÇK jepte goditje të fuqishme me formacione të mëdha, me brigada dhe reparte, në tërë territorin e Kosovës.

Përdorimin e kësaj taktike e diktoi edhe një faktor tjetër i rëndësishëm që kishte lidhje me fillimin e fushatës së bombardimeve ajrore të NATO-s. Këto bombardime, forcat e ushtarake serbe u përhapën dhe maskuan nëpër qendrat e banuara, si dhe nëpër pronat dhe deri nëpër shtëpitë e Kosovarëve të zonave përkatëse. Prandaj, veprimet e forcave të UÇK-së, që përkohë me këtë fazë u bashkërenduan, në shumicën e tyre, me sulmet ajrore të NATO-s.

Nga ana tjetër, edhe organizimi i forcave ishte në raport të drejtë me fazat e luftës së Kosovës. Kështu, në fazën e parë natyrisht që u formuan grupe të vogla apo njësite guerile, sipas disa skemave tejet të fshehta (konspirative), me lidhje ndërmjetëse. Por, komandantët e grupeve ishin të njohur për të tjerët, tipike kjo për luftën guerile. Por, në fazën e dytë, grupet u zgjeruan në përmasat, duke shtuar numrin e anëtarëve, si dhe duke u njohur me komandantët e tyre.

Në fazën e tretë, kohë kur lufta nisi të zgjerohej dhe radhët e UÇK-së nisën të shtohen me shpejtësi me vullnetarë të rinj, u bë i ngutshëm organizimi i reparteve të UÇK-së. Për organizimin e tyre

ndihmuan oficerë profesionistë të karrierës, të ardhur në Kosovë nga Kroacia, Bosnja, të larguar nga ushtria e ish-Jugosllavisë, si dhe disa oficerë të liruar, të ardhur nga Shqipëria. Për rrjedhojë, UÇK nisi të marrë formë si ushtri e rregullt, me rreshtim organik, uniforma, armatime, kazerma dhe qendra stërvitore brenda në Kosovë dhe jashtë saj.

Së fundi, në fazën e katërt, që ishte përmbyllëse, kur UÇK ishte shtuar shumë në pikëpamje numerike dhe fuqizuar ndjeshëm në pikëpamje ushtarake dhe kishte ardhur për të përmbushur qëllimin kryesor të luftës, UÇK pësoi shndërrime cilësore edhe në aspektin e rëndësishme organizative ushtarake. Tanimë struktura e UÇK-së u organizua mbi bazën e njërive të mëdha, si brigada, që është njësi më e madhe ushtarake dhe më e fuqishme njëherësh.

Andaj, në maj të vitit 1999, UÇK numëronte 40-50 mijë luftëtarë dhe oficerë e nënoficerë gjithsej. Ata ishin rënduar në shtatë zona operative. Kjo ushtri drejtohej nga Shtabi i Përgjithshëm që përfshinte Shtabin Ushtarak dhe Drejtorinë Politike. Shtabi Ushtarak kishte në përbërje disa drejtori shumë të nevojshme si: e Zbulimit, Logjistikës, Personelit e Mobilizimit, Ndërlidhjes, Financës nga Policia Ushtarake dhe Informimi.¹²Në pikëpamje të pajisjes me armatime, UÇK ishte armatosur me automatikë, mitraloza, mortaja dhe topa kundërtank. Efektiviteti i brigadave nuk ishte i njëjlojtë. Nga njëra brigadë tek tjetra ky numër ishte i ndryshëm, por mesatarisht ky numër shkonte nga 1200 në 1800 luftëtarë, bashkë me oficerët dhe nënoficerët e tyre.

Më 10 qershorin e vitit 1999, pas luftës së saj me mbështetjen e fuqishme të NATO-s për shtatëdhjetekatër ditore, UÇK hyri fitimtare në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Megjithatë, në Shqipëri, në

¹² FESH-3, f.2829

vitin 1997-1998, ndonëse Qeveria shqiptare e kohës i ruhej një reagimi të komunitetit ndërkombëtar, përfaqësuesit e UÇK-së u lidhën dhe u ndihmuan nga institucionet e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Informimit Shqiptar. Nëpërmjet kësaj marrëdhënie, që doli se ishte e duhura dhe vendimtare, teksa konflikti po përhapej, UÇK-ja mori ndihmën e mundshme.¹³ Duke pasur parasysh gjendjen e vështirë që po kalonte Shqipëria, sidomos në zonën në Veri të vendit, stërvitja ushtarake dhe furnizimeve me armë ishte më i mundshëm. Nga disa të dhëna arkivore dhe disa autorëve, mbështetja gatishmëria e shtetit dhe e Ushtrisë shqiptare për forcat nga Kosova është e hershme.

Mbas Marrëveshjes së Dejtonit për Bosnjën, në Kosovë arriti të shikohej me mosbesim qasja pacifiste dhe premtimi i Rugovës që vijonte edhe pas kaq vjetësh se perëndimorët do të merreshin me çështjen e Kosovës. Por kjo çështje kishte çuar dëm dhe zhgënjyer kosovarët. Ndërkohë, UÇK-ja me grupet e saja të armatosura kishte ndërmarrë aksione kundër forcave policore serbenë zona të ndryshme të Kosovës, duke tërhequr vëmendjen e kosovarëve. Veçanërisht pas dështimit të Marrëveshjes Rugova-Milloshëviq, e shtatorit 1996, me ndërmjetësinë e SHBA-së dhe të disa shteteve evropiane, UÇK-ja u pa si një arsye më shumë se *“qeveritë e vlerësonin argumentin e fjalës më pak se atë të forcës”*.¹⁴ Për rrjedhojë, UÇK nuk linte rast pa sulmuar forcat policore serbe, vijonte ndërkaq që me anën e grupit gueril të fuste armë përmes shtigjeve malore, nga Shqipëria, si dhe të stërvitej ushtarakisht nga oficerë të Ushtrisë shqiptare. Ndërsa UÇK-ja po e shtonte veprimtarinë luftarake të saj kundër forcave policore serbe që të tërhiqte vëmendjen e SHBA-së dhe Evropës, në Shqipëri kaploi kriza

¹³ Abrahams, f. 312

¹⁴ Abrahams, 318.

e pashembullt shkatërruese e fillimit të vitit 1997. Kriza çoi në dëmtimin e Ushtrisë shqiptare, në hapjen e shumë depove të saj, duke rrëmbyer e përhapur gjithandej shumë armë dhe pajisje të tjera ushtarake. Kjo gjendje u kthye në një burim për furnizimin me armë e municione dhe të forcave të UÇK-së, sidomos përmes blerjes së tyre tejet të leverdishme. Kësisoj kjo e keqe shërbeu për mirë, në rastin e luftës së Kosovës.

Për rrjedhojë UÇK-ja pati një rritje të ndjeshme që, në verën e vitit 1997, për shkak të përforcimit të kësaj force të armatosur, u krijuan disa “*territore të çliruara*” në disa pjesë të Kosovës ku policia serbe nuk guxonte të futej. Më 25 nëntor, pas një përleshje mes forcave serbe me ato të UÇK-së në lagjen e Binakëve në Vojnik, nën udhëheqjen e Abedin Rexhës, bënë qëndresë të fortë, gjë që i detyroi forcat serbe të tërhiqeshin. Të nesërmen (26 nëntor) në vendin e quajtur Klysyre mes fshatit Llaushë dhe Rezallës se Re në komunën e Skenderajt, njësitet e UÇK-së së Drenicës, organizuan mbrojtjen ballore, duke zbatuar taktikën e befasisë me prita në një hapësirë të madhe. U zhvillua një betejë e cila zgjati rreth 2-3 orë, me c’rast forcat serbe pësuan humbje në teknikë luftarake, pati të vrarë dhe të plagosur. Forcat serbe gjatë kthimit për në Skenderaj, shtien me armë pa kontroll mbi popullsinë. Me këtë rast, u plagosë mësuesi Halit Geci i cili rrugës për në spital ndërroi jetë.¹⁵ Më 28 nëntor, në varrimin e tij morën pjesë tre luftëtarë të UÇK-së të veshur me rroba ushtarake. Kjo dalje e tyre u pa si shfaqja e parë publike e UÇK-së, si e vetmja forcë, e cila luftonte për çlirimin dhe unitetit kombëtar të Kosovës. Njëri nga tre burrat e UÇK-së kishte

¹⁵ Sabit Syla, *Beteja e Klysyres (26 nëntor 1997)*, Fjalori Enciklopedik i Kosovës, I, A-K, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2008, f. 177.

deklaruar se: “Ne do të vazhdojmë të luftojmë”,¹⁶ ndërsa të pranishmit në varrim u përgjigjën me thirrjet UÇK, UÇK!

Në vitet pasuese, ndërsa lufta po përhapej me shpejtësi në territorin e Kosovës, UÇK-ja u mbështet më së shumti në institucione të tilla të shtetit shqiptar, si, Policia, SHIK-u, dhe Ushtria shqiptare, për të cilat kishte aq shumë nevojë.

Më datën 6 mars të vitit 1998, në fshatin Prekaz, pas një qëndrese të ashpër mbeti i vrarë një ndër njerëzit më të njohur të UÇK-së me pothuajse gjithë familjen e tij. Kjo vrasje solli një rebelim të vërtetë, të paparë deri atëherë, në Kosovë, dështimin e pacifizmit të Rugovës dhe shtimin e radhëve të UÇK-së si dhe të veprimtarisë së saj luftarake. Ndërkohë, Qeveria shqiptare vijonte të mbështeste në fshehtësi (hije) UÇK-në me informacione, këshillime dhe asistencë ushtarake në stërvitjen e rekrutëve kosovarë si dhe kalimin dhe organizimin për në brendësi të Kosovës.

Ndërkaq UÇK-ja u përpoq që t’u përmbahej premtimeve që kishin bërë kundrejt CIA-s amerikane, për të mos pranuar ndihma nga burime islamike, të mos pranonin financime të ardhura nga droga, ashtu si dhe të mos kryente veprime jashtë territorit të Kosovës¹⁷, por ato argumente që shënuan kthesën në raport me luftën dhe mbështetjen e UÇK-së, për SHBA-në, ishte padyshim ajo që ka hyrë në histori si “masakra e Reçakut”. Ajo bëri që SHBA, dhe kryekomandanti i NATO-s të binin dakord për bombardimin.

Ajo që i hapi rrugën veprimeve të NATO-s ishte Marrëveshja e Rambujesë ne Francë, më 6 shkurt 1999. Marrëveshja u firmos nga

¹⁶ Judah Tim, *Kosovo and Revenge* (New Haven, Conn, and London: Yale University Press, 2000), f. 136-137.

¹⁷ Abrahams, 329.

delegacioni shqiptar, më 18 mars 1999. Pas kësaj, bombardimet e avionëve të NATO-s, të ndihmuar nga UÇK nga toka për orientimin me objektivat serbe filluan sulmet nga ajri. Ndërsa, Qeveria shqiptare, përveçse me aerodromet për NATO-n, e ndihmoi me gjithçka edhe UÇK-në, si dhe pranoi në Shqipëri qindra mijëra kosovarë të përzënë nga forca ushtarako-policore serbe, duke i strehuara ata. Por, Qeveria shqiptare, në ndryshim me nëntorin e vitit 1998, lejoi ardhjen në Shqipëri të shumë meshkujve kosovarë që vinin nga jashtë vendit për të marrë pjesë në luftën për çlirimin e Kosovës. Ata vinin nga shumë vende të Evropës, por edhe nga SHBA-ja e largët.

Shqipëria luajti në këtë rast, një rol të rëndësishëm në pritjen, organizimin dhe përgatitjen e forcave të tjera luftarake për UÇK-n, në luftë kundër forcave ushtarako-policore serbe në Kosovë.

Shqipëria është jo vetëm një vend kufitar me Kosovën, por edhe një vend me origjinë të njëjtë kombëtare për kosovarët, prandaj ajo e mbështeti në çdo çast dhe me çdo mundësi, ndonëse shpesh nën presion të ndërkombëtarëve.

Kjo ndihmë përfshinte disa tregues të rëndësishëm, që ndikonin në organizimin, stërvitjen dhe përgatitjen luftarake të luftëtarëve dhe komandanteve të formacioneve luftarake të UÇK-së. Pavarësisht që, deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s mbi forcat ushtarako-policore, shteti dhe Qeveria shqiptare të tërhequra por ishin institucionet e tyre të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Informacionit, që do të ndihmonin sa më shumë dhe me të gjitha mundësitë e tyre, gjithsesi të kufizuara, për shkak të situatës që kaloi vendi në vitet 1997-1998.

Në luftën e Kosovës dhe në organizimin e veprimtarisë së UÇK-së kanë dhënë një ndihmesë të çmuar, duke ndikuar në veprimtarinë e tyre, disa faktorë: gjeografikë, etnikë, ushtarakë etj.

Një ndër vendet që për shkak të pozicionit gjeografik, të origjinës së njëjtë kombëtare dhe të përvojës ushtarake në pikëpamje organizative dhe të trajnimit profesional, por edhe logjistikë ishte padyshim Shqipëria. Këtë e mendonin, së pari, kosovarët, por edhe ndërkombëtarët dhe, sidomos, serbët! Në një analizë të shpejtë, në pikëpamje gjeografike, Shqipëria ishte fare pranë apo ngjitur me Kosovën dhe mundësi më të mëdha komunikimi që për shkak të porteve detare dhe aeroportit, mundësonte ardhjen e shumë emigrantëve kosovarë, që donin t'i bashkoheshin UÇK-së, në luftën e Kosovës. Aq më shumë rritej kjo mundësi nëse i shtohet këtij fakti edhe një argument tjetër. Ky argument që i shtonte mundësitë e mësipërme, ishte identiteti i njëjtë kombëtar shqiptar në të dy anët, në Shqipëri dhe Kosovë. Ndërsa, nga ana e kufirit me Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, hyrjet veçanërisht, por edhe daljet, ishin tejet të vështira, për të mos thënë në kufijtë e të pamundurës për lëvizjen e luftëtarëve dhe aq më pak të furnizimeve logjistike ushtarake të UÇK-së.

Në këtë mënyrë, rrethanat dhe argumentet e mësipërme ndikuan që, një barrë e konsiderueshme të binte mbi Shqipërinë për sa i përket lëvizjes së forcave dhe rrugëve të furnizimeve të UÇK-së, krahas atyre më sipër, lidhej me përgatitjen luftarake të emigrantëve kosovarë që vinin nga vendet e Evropës dhe nga SHBA-ja e largët për të luftuar në Kosovë. Mirëpo, të gjitha lëvizjet dhe veprimtaritë e mësipërme, më shumë se kudo tjetër, ishin nën vëzhgimin e përhershëm të vendeve evropiane dhe të vëzhguesve amerikanë, por më së shumti nga spiunët dhe agjentët e Policisë së fshehtë dhe kundërzbulimit serb edhe brenda

në Shqipëri. Ky vëzhgim euro-amerikan që veçanërisht i vazhdueshëm dhe i shoqëruar me këshillime të pandërprera kur u zhvillua lufta e Kosovës.

Qeveria shqiptare ndihmoi dhe mbështeti NATO-n, kur ajo vendosi që të niste fushatën e bombardimeve kundër Serbisë, në mbështetje të luftës së UÇK-së për çlirimin e Kosovës. Qeveria shqiptare vuri në dispozicion të NATO-s aerodromet prej nga niseshin avionët e saj për të goditur objektivat serbe.

Në një vështrim retrospektiv, ndihmesa që shkonte në interes të organizimit të forcave të UÇK-së, i ka fillimet e saj më herët në kohë. Nga disa të dhëna dokumentare dhe studime të publikuara ashtu siç kemi përmendur më parë, ndihmesa për forcat e UÇK-së, ka ardhur që në fazën e Tretë të organizimit të kësaj ushtrie. Në këtë fazë, kur nisi krijimi i reparteve të UÇK-së, në ndihmë të këtij procesi të rëndësishëm u ofruan oficerë profesionistë të ardhur në qendrat e grumbullimit, organizimit dhe të përgatitjes luftarake në Kosovë nga këta oficerë përveçse profesionistë, zotëronin edhe përvojë të pasur luftarake nga Kroacia, Bosnja si dhe disa oficerë shqiptarë të liruar para kohe nga Ushtria shqiptare, për shkak të Reformës ushtarake në të cilët kishin ardhur vullnetarisht në ndihmë të organizimit dhe përgatitjes luftarake të forcave të UÇK-së.

Në fazën e katërt, apo përmbledhëse dhe kurorëzuese të luftës së Kosovës, numri i vullnetarëve kosovarë që vinin nga vendet evropiane dhe SHBA me synimin për të marrë pjesë në këtë luftë, kryesisht përmes porteve detare dhe aeroportit të vendit shqiptar, u shtua dukshëm. Për rrjedhojë, lindi nevoja për organizimin nëpër reparte apo njësi luftarake dhe të përgatiteshin ushtarakisht të tyre, për t'u nisur më

pas drejt veriut të vendit, prej ku këto reparte e njësi marshonin ushtarakisht për në zonat e përcaktuara në Kosovë.

Për këtë arsye u pa e nevojshme që procesin e mësipërm, këta vullnetarë ta kryenin në Shqipëri. Pas përgatitjes në Shqipëri, këta luftëtarë do të hynin menjëherë në luftë në Kosovë. Kjo përbënte një përparësi të madhe për UÇK-në. Por, veçse kjo nuk ishte aspak e lehtë, për shkaqe që i theksuam më parë, të vëzhgimit të rreptë të vëzhguesve ndërkombëtar, si dhe të agjenturës serbe. Që në prill të vitit 1998, UÇK dhe CIA amerikan, me ndihmesën e SHIK-ut shqiptar, kishin rënë në një mendje për tri pika thelbësore në veprimtarinë e UÇK-së, që shkurtimisht me kushtin që UÇK të mos ushtronte dhunë jashtë Kosovës, të mos bashkëpunonte me forca terroriste dhe jo financime të paligjshme. Për rrjedhojë, UÇK-ja, nuk u përfshi asnjëherë në listat e Departamentit të Shtetit për organizatat terroriste. Madje, siç shkruan Abrahams “ka dëshmi që tregojnë për stërvitje të kryera nga ekspertët amerikanë dhe britanikë në kampet e UÇK-së në Shqipërinë e Veriut. Çka ishte më e rëndësishme për UÇK-në, ajo po forconte besimin”.¹⁸

Pas kësaj, për UÇK-në pati një ecuri që shkonte në drejtimin e duhur duke kulmuar me bashkëpunimin me NATO-n gjatë bombardimeve mbi Serbi, në marsin e vitit 1999. Pikërisht për arsyet e mësipërme, sidomos pas masakrës serbe në fshatin Reçak të Kosovës, kishte ardhur çasti i kthesës së madhe.

Pas nënshkrimit të vështirë të Marrëveshjes së Rambujesë, të 18 marsit 1999, kosovarët fituan mbështetjen konkretet të NATO-s, e cila filloi bombardimet ajrore mbi objektivat ushtarake strategjike të Serbisë.

¹⁸ *Po aty*, 326.

Pas kësaj, qeveria shqiptare u vu në mbështetje, si të forcave të NATO-s edhe të UÇK-së me të gjitha mundësitë që pati, ndërkohë që në publik e “hodhi poshtë” mbështetjen dhe ndihmesën e drejtpërdrejtë dhe konkrete. Tanimë, Qeveria Majko, pranoi në portet detare dhe ajrore prurjet në përmasa të mëdha të mijëra vullnetarëve kosovarë, që arrinin në Shqipëri nga disa vende të Evropës Perëndimore dhe SHBA, me qëllimin e vetëm për të luftuar në radhët e UÇK-së.

Por, shumica e këtyre vullnetarëve nuk kishin njohuri për organizimin ushtarak dhe aq më pak për taktikën e luftës dhe përdorimin e armëve në luftimet. Ata nuk njihnin jetën, disiplinën, uniformat, rreshtimin, urdhrat e eprorëve dhe bindjen për zbatimin e tyre. Pra, ata nuk e njihnin as betimin ushtarak për sakrifica, përkushtimin deri në rënie për lirinë e popullit dhe atdheut.

Të ardhurit ishin të moshave nga 15 vjeç më e ulëta, deri në 55 vjeç më e larta, por dominonin moshat nga 25 deri më 35-vjeçare, që zinte 75% të vullnetarëve kosovarë. Prej afro 1800 vullnetarëve që pas gjashtë ditësh arritën në afro 2500 vetë, meshkuj dhe femra, rreth 40% e tyre e kishin kryer shërbimin ushtarak në ushtrinë e ish-jugosllave më parë. Kjo përvojë reflektohej qartë në qëndrimin e tyre rreshtor, në pamjen e jashtme, mënyrën si reagonin dhe zbatonin urdhrat, por, sidomos në përdorimin e armëve, stërvitjen e përgatitjen ushtarake dhe qitjet me rezultate të larta.

Pjesa tjetër, më e madhe e vullnetarëve, kishin mangësi dhe vështirësi të dukshme në pamjen e jashtme, në mbajtjen e uniformës, në qëndrimin rreshtor, në përgatitjen ushtarake taktike, mosnjohjen dhe përdorimin e armëve dhe veçanërisht në qitje.

Për rrjedhojë, sipas të dhënave që vijnë nga disa burime, në territorin e Shqipërisë u ngritën dy qendra kryesore, pikërisht për

organizimin dhe përgatitjen e forcave vullnetare që mbërrinin nga vende të ndryshme të Evropës dhe SHBA-së për të hyrë në radhët e UÇK-së, sipas autorit Fred Abrahams, “UÇK-ja përdori të paktën dy baza të ushtrisë shqiptare për të stërvitur rekrutë...”¹⁹. Me rekrutë ai nënkuptonte vullnetarët kosovarë të mbërritur në Shqipëri që nga muaji prill i vitit 1999, për t’iu bashkuar UÇK-së në Kosovë. Këtë të dhënë për qendrat stërvitore të mësipërme i pohon në një libër edhe një autor shqiptar, Halil Katana.²⁰ Por, sigurisht, që për këto baza është ruajtur fshehtësia për shkaqe të kuptueshme. Veçanërisht deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s, ngritja e qendrave ishte bazuar në urdhrat e ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë. Por, ndoshta është vendi për të folur shkurtimisht për veprimtarinë që kryhej në këto qendra, me detyrat dhe rregullin e funksionimit të tyre. Ato kishin për qëllim kryesor që, pas ardhjes në to në fshehtësi të vullnetarëve kosovarë, të merreshin me organizimin e tyre nëpër nënreparte, reparte e njësi ushtarake.

Si rregull, në këto qendra, vullnetarëve kosovarë u jepeshin, brenda një periudhe disa javore (20-25 ditë), një varg njohurish ushtarake që nga ana formale deri te ato speciale-profesionale. Njohuritë nisnin me nderimin për flamurin dhe himnin kombëtar, qëndrimin rreshtor, nderimin, urdhrat ushtarakë dhe rëndësinë e zbatimit të tyre, mbi disiplinën dhe moralin në luftë. Ndërkohë atyre u jepeshin mësimet teorike dhe sidomos praktike për njohjen dhe përdorimin e taktikave të luftës, në mbrojtje, mësymje (sulm), në veprimtarinë e nënreparteve, po ashtu si dhe për bashkëpunimin dhe mënyrat e ndërlidhjes. Madje, në këto qendra atyre ju dhanë njohuri

¹⁹ Abrahams, 340.

²⁰ Halil Katana, Kudusi Lama - gjenerali i luftës, Tiranë, 2002, f.304.

xheniere për minat dhe ndërtimin e pozicioneve të mbrojtjes, deri edhe për mbrojtjen nga lëndët kimike që mund të përdornin forcat ushtarako-policore serbe gjatë luftimeve.

Por, rëndësi u jepej në to edhe përgatitjes fizike, si dhe mënyrës së kryerjes së marshimeve luftarake me nënrepartet dhe repartet e tyre përkatëse. Pas betimit ushtarak, që bënin duke nënshkruar deklaratën e betimit më pas, duke kulmuar me stërvitjen ushtarake, repartet dhe njësitë e përgatitura, niseshin drejt veriut të Shqipërisë, siç shkruan Abrahams, “për stërvitje dhe mandej në front”.²¹

Ndoshta tani është koha për të treguar përmbledhtas së si veprohej konkretisht në njërën prej qendrave të organizimit dhe përgatitjes të vullnetarëve që vinin në Shqipëri për të kaluar më pas në Kosovë, në frontet e luftës që zhvillohej aty mes forcave të UÇK-së dhe forcave ushtarako-policore serbe.

Në prill të vitit 1999, në njërën prej qendrave stërvitore të Ushtrisë në Shqipëri, mbërritën nga SHBA, disa qindra vullnetarë që më pas u organizuan në atë që, më pas, u emërtua “Brigada e Atlantikut”. Shumica e tyre nuk kishin qenë në shërbim ushtarak dhe për pasojë nuk kishin njohuri për qëndrimin në rresht, për disiplinën ushtarake, për armët dhe qitjet, por ata kishin mangët, sidomos për taktikat e luftës etj.

Sipas të dhënave dokumentare të kohës, për të organizuar dhe përgatitur si luftëtarë vullnetarët nga SHBA-ja, që fillimisht kapnin shifrën 1800 vetë, por vetëm pas gjashtë ditëve arritën në afro 2500 vetë, ishte përzgjedhur një grup oficerësh, mësime dhëniesh metodikë dhe me përvojë. Në afro tre-katër javë, grupi i madh i vullnetarëve u organizuan mbi bazën e batalioneve, kompanive, togave dhe

²¹ Abrahams, 340.

skuadrave, me komandantët e tyre në krye. Ato u organizuan sipas modelit të ushtrive të kohës. Komandantët e nënreparteve të pariorganizuara, në rastin më të mirë ishin ish-oficerë të ushtrisë jugosllave, ose vinin nga radhët e atyre që kishin kryer shërbimin ushtarak më parë. Për të arritur synimet e përgatitjes ushtarake dhe luftarake të vullnetarëve ishte përgatitur një program. Në të ishin përfshirë tema mbi stërvitjen rreshtore, përgatitje zjarri për të njohur armët në përdorim, taktikë për disa lloje luftimesh, njohuri për disa specialitete kryesore si xhenio, ndërlidhje dhe mbrojtje kundërkimike, si dhe qitje pothuajse me të gjitha armët që përdorte UÇK-ja. Është e kuptueshme që pjesën kryesore të programit e zinin njohuritë teorike dhe sidomos stërvitje taktike praktike si dhe mësimet për njohjen e armëve personale dhe kolektive, të cilat kulmonin me qitje reale në terren. Siç kemi shkruar më parë, të gjithë vullnetarët zhvilluan qitje me automatikë, mitraloza, topa kundërtank, granatahedhës të lehtë, madje edhe me granata dore.

Mësimet dhe stërvitja praktike taktike për luftimet mbrojtëse, pozicionale dhe sulmuese apo në prita mësohej sipas artit ushtarak bashkëkohor dhe jo sipas luftimit tradicional që ata njihnin nga të parët apo që kishin lexuar. Për t'iu afruar dhe përshtatur sa më shumë terrenit në Kosovë, stërvitjet u zhvilluan në terrene fushore, kodrinore dhe në terrene të thyera e malore. Nga ana tjetër, vëmendje e veçantë iu kushtua stërvitjeve me efektivë, për një forcë si ajo e UÇK-së që luftonte në terrenin e saj që e njihte më mirë se forcat serbe.

Stërvitjet e kryera edhe në kushte të rënda të motit, me shira dhe baltë, duke u gërshetuar me lëvizjet dhe marshimet e shpejta e të përhershme si dhe masakrimet sipas terrenit konkret. Programi ishte konceptuar mbi bazën e orëve mësimore me nga 50 minuta secila,

kurse një ditëstërvitore zgjaste deri në 8 orë. Ndërsa, stërvitjet e natës fillonin pas rënies së errësirës dhe zgjasnin deri afër mesnatës. Në program ishte parashikuar edhe stërvitja për mbijetesën e efektivave në përgatitje si: ushqimi i thatë, fjetja në fjetore të përbashkëta me qindra vetë dhe në kushte të vështira, në natyrë etj. Duhet theksuar se shumica e vullnetarëve vinin nga jeta civile e lirë dhe në emigracion. Fillimisht patën vështirësi, por shpejt i tejkaluan ato dhe i përvetësuan njohuritë e nevojshme për luftë. Më në vështirësi u përvetësuan elementët e stërvitjes rreshtore, dhëniet e komandave, stërvitje taktike të luftës apozicionale e ndonjë tjetër. Efektivi i repartit të Atlantikut që njihet edhe si Brigada e Atlantikut, i ardhur nga SHBA-ja, sipas të dhënave të një informacioni të korrikut 1999, kishin kryer shërbim ushtarak në një masë të konsiderueshme. Ata fillimisht patën probleme me disiplinën ushtarake që e tejkaluan shpejt, ndërsa kishin njohuri të mira për armatimin dhe rezultate të mira në stërvitje taktike dhe në qitje. Në fillimet e çdo dite u dha përparësi ngritjes së flamurit dhe këndimit të himnit kombëtar. Për të kuptuar sesa shumë vlerësohej nga vullnetarët ngritja dhe prezenca e flamurit dhe këndimi i himnit kombëtar, mund të thuhet se riti i tyre shoqërohej çdo ditë me duartrokitje dhe emocion.

Njëherësh, dukej se ato ceremoni (rituale) ndikonin mjaft në gjendjen morale dhe psikologjike të vullnetarëve për t'u stërvitur me zell dhe për t'u monitoruar, për të shkuar sa më parë e të përgatitur në luftën për çlirimin e Kosovës.

Në ditët e para problem përbënin pajisja me uniforma të njëjta, si dhe kundërshtimi i organizimeve mbi bazë krahinore, fisi apo familjare aq më tepër klanore. Ato prirje u mënjanuan me kujdes nga oficerët që drejtuan organizimin dhe përgatitjen ushtarake të vullnetarëve, duke

shpjeguar se në luftë shkohej me organizim ushtarak të kohës dhe sipas traditës dhe zakoneve!

Për ta përmbyllur këtë ngjarje me rëndësi u aplikua edhe forma e betimit ushtarak dhe nënshkrimi i tij. Kjo ditë u vlerësua shumë nga luftëtarët si një simbolikë e të qenit gati për të shkuar në luftë për lirinë e atdheut, Kosovës!

E gjithë fushata e bombardimeve të NATO-s nga bashkëpunim nga toka të forcave të UÇK, por edhe me mbështetjen indirekte të Shqipërisë pranë, u përmyll brenda shtatëdhjetë e tetë ditëve (24 mars -1 qershor). Më 9 qershor të vitit 1999, Millosheviq urdhëroi që ushtria e tij të ndalonte veprimet, ndërsa u nënshkrua një marrëveshje për tërheqjen e trupave serbo-jugosllave nga Kosova. Në të do të hynin trupat e NATO-s, kurse krahina tashmë e lirë, do të administrohet nga OKB-ja. Shqipëria me institucionet e saj qeveritare kishte luajtur rolin e saj në dobi të bashkëkombëseve të saj në Kosovë si gjatë krizës, ashtu edhe gjatë përgatitjes së forcave të UÇK-së për luftën e çlirimit të Kosovës.